



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 63 / Prot.

3

04.03.22

Tiranë, më 04 .03.2022

V E N D I M

Nr. 18 , datë, 04 . 03. 2022

PËR DHËNIE MASË DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i përbërë nga anëtarët Arjan Muça, Albert Muço, Hari Gogo, Alfred Progonati, kryetar dhe në mungesë të anëtarit, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Daniel Noga, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numër protokollit 64, datë 23.12.2021, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.03, datë 11.01.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Daniel Noga , për kryerjen e shkeljes disiplinore,
- “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”,
parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 3, gërma “ç” dhe pika 4, gërma “ç”.

1. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe dokumentat që e shoqërojnë atë, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Daniel Noga, gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të procedimit penal nr.613, regjistruar në datën 23.06.2021, në ngarkim të shtetasve Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, për veprat

penale, “*Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror*”, dhe “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, parashikuar nga nenet 297 dhe 298/1 i Kodit Penal.

Nga kërkesa, relacioni shoqërues i propozimit të prokurorit Andi Pogçe dhe aktet e dosjes rezultojnë se:

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në datën 23.06.2021 ka regjistruar procedimin penal Nr.613, në ngarkim të shtetasve Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, për veprat penale, “*Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror*”, dhe “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, parashikuar nga nenet 297 dhe 298/1 i Kodit Penal. Veprimet hetimore për këtë procedim penal, janë kryer nga oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, Arben Mihaj dhe Daniel Noga. Oficeri i Policisë Gjyqësore Arben Mihaj ka bërë dhe referimin e materialeve hetimore në prokurori.

Nga materiali referues rezultojnë se shërbimet e Policisë së Qarkullimit Rrugor pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, kanë konstatuar në datën 22.06.2021, në aksin rrugor Fier – Lushnjë, duke qarkulluar, automjetin tip autobus, i markës “Mercedes Benz”, me targa AA 722 DH, që drejtohej nga shtetasi Besnik Krasniqi, i pajisur me leje drejtimi dhe licencë për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjën ndërqytetase, Durrës – Fier – Durrës. Në automjet janë konstatuar shtetasi Roland Jaho, me banim në Durrës dhe 5 shtetas të huaj, me shtetësi siriane, të identifikuar nga punonjësi i policisë si shtetasit: Ahmed Wail, Shahad Almohamad, Halit Hamit, Ibrahim Farzat dhe Fahd Mohammad.

- Shtetasit sirian janë shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale. Pyetja e tyre është kryer në prani të një punonjësi policie i cili kishte njohuri në gjuhën angleze. Shtetasit sirian kanë deklaruar se janë futur në territorin shqiptar nga shteti Grek në mënyrë të paligjshme nga kufiri i gjelbër, pranë Pikës Kufitare të Kakavijës, duke përdorur aplikacionin “google map”, dhe duke ecur disa ditë në këmbë. Ata kanë deklaruar se kanë patur si qëllim të shkonin në Tiranë dhe më pas drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Në datën 22.06.2021 kanë hipur në një autobus në qytetin e Fierit, ku shoferi i autobuzit pasi u ka prerë biletat e udhëtimin, u ka marrë shumën prej 3000 lekësh.

- Në vijim të kryerjes së veprimeve të para hetimore, është pyetur drejtuesi i automjetit Besnik Krasniqi, i cili ka shpjeguar se ditën e ngjarjes ka marrë në autobuz, në qytetin e Fierit shtetasin Roland Jaho dhe 5 shtetas të huaj, të cilët kanë shpjeguar se donin të shkonin në Tiranë. Shtetasi Besnik Krasniqi, pasi u ka shpjeguar se shkonte deri në Durrës, i ka hipur në autobus dhe u ka prerë biletat dhe ka marrë prej tyre shumën 3000 lekë. Më pas janë nisur në drejtim të qytetit të Durrësit, por rrugës afër rrethrotullimit të Kolonjës, autobuzi është ndalur nga shërbimet e policisë dhe ai së bashku me automjetin është shoqëruar në polici.

- Është pyetur shtetasi Roland Jaho, i cili ka shpjeguar se ka qenë pasagjer në autobuzin e drejtuar nga shtetasi Besnik Krasniqi dhe se nuk ka patur asnjë lidhje apo njohje me shtetasit sirian që u gjetën në autobus.

- Në kuadër të veprimeve hetimore paraprake, është kryer kqyrja e aparateve celular të shtetasve Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, veprim nga i cili nuk janë konstatuar të dhëna me interes për hetimin.

- Rezulton nga aktet e referuara nga Policia Gjyqësore se, 5 shtetasit e huaj, sirian, janë deportuar nga territiri i Republikës së Shqipërisë me urdhërat e largimit të datës 22.06.2021.

- Në kuadër të veprimeve hetimore paraprake nga ana e Policisë Gjyqësore, në datën 22.06.2021 është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasve Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho për veprën penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal.

2.1. Me marrjen e materialeve nga Policia Gjyqësore dhe njoftimin për arrestimin në flagrancë të shtetasve Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, prokurori Andi Pogaçe, ka konstatuar se arrestimi në flagrancë, i këtyre shtetasve është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit, ndaj me “Urdhërin për lirim të menjëhershëm”, në datën 24.06.2021, ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të shtetasve, Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho. Ky urdhër është ekzekutuar nga oficeri i policisë gjyqësore Arben Mihaj. Arrestimi në flagrancë i shtetasit Roland Jaho është kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Daniel Noga.

Në urdhërin për lirim të menjëhershëm të arrestuarve në flagrancë, Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, nga prokurori Andi Pogaçe argumentohet se: “arrestimi i këtyre shtetasve, nuk është kryer në kushtet e flagrancës, sepse ata nuk janë kapur në kryerje të veprës penale ose menjëherë pas kryerjes së saj, duke qenë se në momentin e arrestimit, policia nuk ka pasur asnjë të dhënë lidhur me qëllimin e udhëtimit apo lidhur me qëllimin që kanë patur shtetasit sirianë. E dhëna e vetme që është disponuar në momentin e arrestimit ka qenë fakti se në autobuzin e linjës Fier – Durrës, të drejtuar nga shtetasi Besnik Krasniqi kanë qenë duke udhëtuar disa shtetas të huaj, pa pasur asnjë informacion tjetër. Për sa kohë neni 298 i Kodit Penal kërkon si element të domosdoshëm të figurës së veprës penale qëllimin e posaçëm që është kallimi i paligjshëm i kufirit, do të duhej që në bazë të rrethanave faktike të konstatuara në momentin e arrestimit, të krijohej dyshimi për ekzistencën e këtij qëllimi, por nga aktet e përcjella nga policia nuk rezulton një qëllim i tillë. Shtetasit në fjalë nuk janë konstatuar as të fshehur në mjetin e transportit, çka mund të krijonte dyshimin e transportit të tyre me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit dhe rjedhimisht të legjitimonte arrestimin, por përkundrazi si pasagjerë normalë të paisur edhe me bileta udhëtimi.

.... në momentin e arrestimit, oficeri i policisë gjyqësore nuk ka patur asnjë të dhënë për të krijuar dyshimin lidhur me ekzistencën e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal dhe në kundërshtim me nenet 251 dhe 252 të Kodit të Proçedurës Penale. Në proçeverbalin e arrestimit në fakt referohen rrethana që kanë rezultuar pas arrestimit në flagrancë dhe jo rrethanat që janë konstatuar në momentin e kapjes në flagrancë.”

....Si në momentin e kapjes në flagrancë ashtu dhe në momentin e arrestimit nuk rezulton të ketë të dhëna lidhur me faktin se shtetasit e arrestuar kanë qenë në dijeni se shtetasit sirianë kishin hyrë apo dilnin në mënyrë të paligjshme....”

Gjithashtu, nga ana e prokurorit Andi Pogaçe është konstatuar dhe është arritur në konkluzionin se gjatë hetimit të proçedimit penal nr.613/2021, veç arrestimit të paligjshëm, në flagrancë i shtetasit Roland Jaho, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga, janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale, të cilat kanë çuar në pavlefshmëri të veprimeve hetimore dhe kanë sjellë pasoja për hetimin e çështjes. Shkeljet e kërkesave të Kodit të

Procedurës Penale konsistojnë në mossekuestrimin e aparateve celular të shtetasve sirian me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe mosrespektimin e dispozitave që kanë të bëjnë me praninë e nje perkthyesi te licensuar gjat kryerjes së veprimeve hetimore me shtetas të huaj. Kqyrja e aparateve celular të shtetasve sirian është kryer pa praninë e një përkthyesi të licensuar, çka e ka bërë veprimin hetimor të pavlefshëm.

2.2 Këto veprime dhe shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësorë Arben Mihaj, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, janë konsideruar si shkelje disiplinore në formën,

“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 3, gërma “ç” dhe pika 4, gërma ”ç”.

3. Konkluzione të Komisionit të Policisë Gjyqësore

3.1 Komisioni i Policisë Gjyqësore pas analizës së kryer dhe diskutimeve, me votat e anëtarit të Komisionit Albert Muço dhe kryetarit të Komisionit, Alfred Progonati, vota e të cilit, referuar nenit 11, pika 4 e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, është përcaktuese, arriti në konkluzionin se, nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre, shjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, u provua se gjatë hetimit të proçedimit penale nr.613, të vitit 2021, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga, janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale që kanë lidhje me kryerjen e arrestimit në flagrancë, ekzistencën e kushteve dhe rrethanave për kryerjen e tij dhe që garantojnë respektimin e të drejtave proçedurale të subjekteve të përfshirë në nje hetim penal, ku palë pjesëmarrëse në të është shtetasi Roland Jaho dhe ndaj të cilit është kryer veprimi procedurjal, arrestimi në flagrancë. Gjatë kryerjes së arrestimit në flagrancë të shtetasit Roland Jaho në kuadër të këtij proçedimi penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Daniel Noga janë shkelur kërkesat e neneve 251 e 252 të Kodit të Proçedurës Penale, duke sjellë pasoja për ecurinë e proçedimit penal dhe duke cënuar lirinë dhe interesat e ligjshme të shtetasit Besnik Krasniqi.

3.2 U provua me “Urdhërin për lirim të menjëhershëm” të arrestuarve në flagrancë, Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, nxjerë nga prokurori Andi Pogaçe, në datën 24.06.2021 dhe aktet e proçedimit penal nr.613 i vitit 2021, se veprimi i arrestimit në flagrancë i shtetasit Roland Jaho është kryer në shkelje të kërkesave të neneve 251 dhe 252 të Kodit të Proçedurës Penale. Sepse:

- Arrestimi në flagrancë i shtetasit Roland Jaho është kryer pa ekzistuar asnjë e dhënë që krijonte dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në prova se shtetasi Besnik Krasniqi, së bashku me shtetasin Roland Jaho, kanë patur dijeni për qëllimin e udhëtimit apo qëllimin që kanë patur shtetasit sirian. E vetmja e dhënë që është disponuar nga policia në momentin e arrestimit në flagrancë ka qenë fakti se në autobuzin e linjës Fier – Durrës të drejtuar nga shtetasi Besnik Krasniqi kanë qenë duke udhëtuar disa shtetas të huaj, sirian, pa patur asnjë informacion tjetër.

- Vepra penale e dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, kërkon si element përbërës qëllimin e posaçëm, i cili është kalimi i paligjshëm i kufirit dhe dhënia e ndihmës bëhet për

realizimin e këtij qëllimi. Për rastin konkret do të duhej që në bazë të rrethanave faktike të konstatuara në momentin e arrestimit në flagrancë, të krijohej dyshimi për ekzistencën e këtij qëllimi. Por nga aktet që policia ka referuar në prokurori nuk rezultojnë të dhëna që të tregojnë se i arrestuari Roland Jaho ka patur për qëllim të ndihmojë shtetasit sirian për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Përkundrazi nga këto akte tregohet se shtetasit sirianë janë identifikuar si pasagjerë normal dhe të paisur me biletë udhëtimi.

- Referuar po akteve të dosjes dhe proceverbalit të arrestimit në flagrancë, rezulton se në momentin e arrestimit, oficeri i policisë gjyqësore, Daniel Noga nuk ka patur asnjë të dhënë për të krijuar dyshimin se ndodheshim para veprës penale të dhënies ndihmë për të kaluar kufirin, të kryer nga shtetasi Roland Jaho.

- Në materialin referues të policisë gjyqësore, nuk referohet asnjë e dhënë apo element ku mbështetet konkluzioni i oficerit të policisë gjyqësore për ekzistencën e bashkëpunimit midis dy të arrestuarve në flagrancë, dhe ku evidentohet ky bashkëpunim në momentin e kryerjes së arrestimit në flagrancë.

- Si në momentin e kapjes në flagrancë, dhe në momentin e arrestimit në flagrancë nuk rezultojnë të dhëna që tregojnë se shtetasit e arrestuar, Besnik Krasniqi dhe Roland Jaho, kanë qenë në dijeni se shtetasit sirianë kishin hyrë në Shqipëri në mënyrë të paligjshme dhe dëshironin që po në mënyrë të paligjshme donin të dilnin nga territori shqiptar. Arrestimi i tyre është kryer duke u mjaftuar vetëm me faktin e transportimit të shtetasve të huaj.

3.3 Shkeljet e sipërcituara që kanë sjelle arrestimin e paligjshëm të shtetasit Roland Jaho, kanë cënuar rëndë lirin e personit dhe kanë cënuar parimet e parashikuara nga ligji për garantimin dhe zhvillimin e procesit të hetimit në mënyrë të tillë që të garantojë të drejtat e shtetasve që ata ti gëzojnë ato pa u cënuar nga veprimet arbitrare të organeve shtetërore.

4. Komisioni i Policisë Gjyqësore, duke ju referuar parashikimeve që ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, në nenin 33, bën për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin, vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me arrestimin në flagrancë, duke mosrespektuar të drejtat procedurale të subjekteve të përfshirë në një hetim penal, dhe duke kufizuar lirin e personit, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Daniel Noga, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që kanë sjellë, përbëjnë shkelje disiplinore, në formën e: **“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasojat për hetimin e çështjes”**, të parashikuara nga neni 33, pika 4 gërma “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Shkelja e kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore Daniel Noga, ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, në pikën 4, gërma “ç” të nenit 33, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, e klasifikon si shkelje disiplinore “shumë të rëndë”.

4.1 Lidhur me këtë shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Daniel Noga, nuk e pranon atë dhe shpjegoi se ka vepruar në përputhje me ligjin, arrestimi në flagrancë është kryer në kushtet e flagrancës, se veprimet kanë qenë dinamike dhe janë kryer në ekip dhe para se të vendosej kjo masë, është diskutuar me eproret e tij, se edhe në rastet e tjera të ngjashme është operuar me arrestimin në flagrancë të cilat, nga prokurori dhe gjykata janë konsideruar të ligjshme.

4.2 Shpjegimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga se veprimet e tij janë kryer në respektim të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe se nga ana e tij nuk janë kryer shkeljet disiplinore që i atribuohen, nuk qëndrojnë dhe nuk justifikojnë shkeljet e kryera prej tij gjate arrestimit ne flagrance te shtetasit Roland Jaho. Sikurse u parashtrua më lartë, me provat që u administruar gjatë zhvillimit të proçedimit disiplinor, u provua plotësisht se prej tij është kryer shkelja disiplinore ***“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”***

4.3 Persa u perket shkeljeve te tjera te parashtruara nga prokurori Andi Pogaçe, qe lidhen me mosrespektimin e dispozitave te Kodit te Procedures Penale lidhur me pranine e perkthyesit, neni 123 e vijues i K.Pr.Penale, gjate kqyrjes së aparateve celular të shtetasve të huaj, apo mossekustrimi i telefonave celular të tyre , Komisioni vlereson se keto shkelje nuk jane te tilla qe ngrihen ne nivelin e shkeljeve disiplinore. Për këtë Komisioni i refrohet i referohet parashikimeve që ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” bënë për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve që ligji i sipërcituar, në nenin 33, u bënë shkeljeve disiplinore të oficerëve të Policisë Gjyqësore, Komisioni vlerëson se, shkelja e kërkesve të K.Pr.Penale Penale që parashikojnë rregullat për pranine e perkthyesit te licensuar gjate kryerjes së veprimeve hetimote me shtetas të huaj, sekustrimin e sendeve provë materiale, (sekustrimi i aparateve celular te shtetasve siriane), janë veprime në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të K.Pr.Penale, por, ato nuk ngrihen në nivelin e shkeljes disiplinore në formën “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, e parashikuar nga neni 33, pika 4, gërma “ç” e ligjit 25/2019.

Shkeljet e sipërcituara teorikisht paraqiten si shkelje te ligjit, por te vendosura ne konteksin e zhvillimit te ngjarjeve, jo gjithmone jane per faj te individit dhe jo gjithmonë ndaj tij duhet te merren masa disiplinore.

Duke i pare shkeljet e pershkruara me lart, ne konteksin e gjithë situates ne te cilen jane zhvilluar ngjarjet, Komisioni cmon te mos i konsideroje ato si shkelje disiplinore per te aritur ne masa disiplinore ndaj oficerit te policise gjyqesore Daniel Noga.

Perkundrazi, duke patur parasysh situaten konkrete, faktin qe prej disa kohesh ne territorin shqiptar futen ne menyre te paligjshme shume shtetas siriane, per shkak te lufterave qe zhvillohen ne vendin e tyre, dhe per pasoje shteti shqiptar ka detyrimin per ti trajtuar si refugjate qe vijne nga vendet e luftes, detyrimin qe autoritetet e shtetit kane per te kryer shpejt veprimet procedurjale, detyrimin qe shteti ka marre per trajtimin dhe deportimin e shpejte te tyre, veshtiresit qe realisht ka Policia e Shtetit per gjetjen dhe sigurimin e perkthyesve te gjuhes se vendeve nga vijne refugjatet, Komisioni gjykon se me veprimet e sipërcituara, oficeri i policise gjyqesore Daniel Noga nuk ka kryer shkelje disiplinore . Komisioni vlerëson se në rastin konkret, shkeljet e kërkesave të K.Pr.Penale nuk janë kryer me dashje dhe nuk janë të qëllimshme. Ato kanë ardhur si rrjedhojë e situates ne te cilen është ndodhur oficeri i policise gjyqesore, jo per fajin e tij.

5. Ne perfundim, Komisioni i Policisë Gjyqësore arin ne konkluzionin se oficeri i Policisë Gjyqësore Daniel Noga ka shkelur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë arrestimin ne flagrante, duke konsumuar elementet e shkeljes disiplinore, **“kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”**, të parashikuar nga neni 33, pika 4 gërma “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Daniel Noga Komisioni i Policisë Gjyqësore për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33, pika 4, gërma “ç” e klasifikon shkeljen disiplinore të kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Daniel Noga si shkelje shumë të rënde.

Gjithashtu Komisioni i referohet nenit 34 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer. Në pikën 4 të nenit 34 të këtij ligji, parashikohet që për shkeljet disiplinore shumë të rënda jepen masat disiplinore “pezullim nga detyra deri në 6 muaj” ose “largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Daniel Noga , Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit lidhur me ngarkesën në punë dhe personalitetin e tij. Komisioni merr parasysh faktin që, gjatë vitit 2020 oficeri Daniel Noga ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune.

Referuar rrethanave të parashtruara më sipër, dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga të japë masën disiplinore **“pezullim nga detyra për 3 muaj”**, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër; në bazë të neneve 10, shkronja “ç”,11, pika 4, nenit 33, pika 4, gërma “ç”, neni 34, pika 1, gërma “ç”, pika 4 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore **Daniel Noga**, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, i jepet masa disiplinore **“Pezullim nga detyra për tre muaj”**.

Për peridhën tremujore të pezullimit, i ndalohet të ushtrojë atributet dhe funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Daniel Noga, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.

3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier .
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Daniel Noga.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ANËTAR

ALBERT MUÇO